



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.397/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për asamble komunale në Komunën e Vushtrri, nga radhët e subjektit politik LDK, Shkelzen Xhaferi, e paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.397/2025, e datës 05.11.2025, e parashtruar nga kandidati për asamble komunale në Komunën e Vushtrrisë, nga radhët e subjektit politik LDK, Shkelzen Xhaferi, e paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 05.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për asamble komunale në Komunën e Vushtrrisë, nga radhët e subjektit politik LDK, Shkelzen Xhaferi, me të cilën pretendon paraqitjen e ankesës kundër certifikimit të rezultateve zgjedhore të shpallura nga KQZ, duke u mbështetur në shkeljet e evidentuara në vendvotimin nr.2729/03. Qëllimi i ankesës është të ruajë integritetin e procesit zgjedhor dhe të sigurojë respektimin e parimeve kushtetuese. për të garantuar zgjedhje të lira dhe të drejtë, si dhe për të ndaluar çdo ndikim të paligjshëm në shpërndarjen e mandateve. Kjo ankesë bazohet dhe mbështetet në dispozitat ligjore dhe kushtetuese të Republikës së Kosovës. Tutje, ka shtuar se vendvotimi nr. 2729/03, i mbajtur në komunën e Vushtrrisë, ka nxjerrë në pah një grup parregullsie dhe të organizuara sistematikisht gjatë ditës së zgjedhjeve, të cilat kanë goditur thellësisht integritetin e procesit zgjedhor, lirinë e votuesve dhe saktësinë e rezultateve. Këto shkelje, ndryshe nga incidente të izoluar, shpalosin një model të qartë dhe qëllimshëm manipulimi, i cili ka ndikuar në përfundimin e votimit dhe në shpërndarjen e mandateve në Asamblenë Komunale. Parregullsitë e identifikuar përfshijnë: Shkelja e sekretit dhe e lirisë së votës pasi që votuesit janë në përballje me pengesa të dyfishta fizike dhe të ushtruara nga individë të paautorizuar

jashtë qendrës së votimit, ku përfshihen edhe anëtarë të subjekteve politike rivale. Janë paraqitur parregullsitë që janë shënuar gjatë procesit të numërimit sepse ka dyshime të thella rreth kontabilitetit të votave jo të vlefshme rinë në ajër, ku disa prej tyre janë shndërruar në mënyrë të dyshimtë në vota të vlefshme pa ndonjë justifikim të përshtatshëm nga komisioni përkatës i vendvotimit. Ky veprim ka ndikuar drejtpërdrejt në shpërndarjen e mandateve duke përfutur subjekte të caktuara dhe duke shkaktuar dëm partisë sime politike, LDK-së. Numërimi u zhvillua në një mjedis ku transparenca ishte pothuajse e pamundur, ndërsa kërkesat e vëzhguesve për verifikim të pavarur u refuzuan. Rrjedhimisht, ekziston potenciali i ndikimit në respektimin e kuotës gjinore, i përcaktuar në nenet 7.2 dhe 8.4 të Ligjit Nr. 03/L-072, ndryshimet e mundshme në rezultatet që vijnë nga rinumërimi apo anulimi mund të prekin renditjen e kandidatëve sipas gjinisë, duke rrezikuar që përfaqësimi i grave në Asambleenë Komunale të bjerë poshtë nivelit minimal prej 30%. Momentalisht, parregullsitë e identifikuara kanë deformuar në mënyrë të paqartë numërimin e votave për kandidatët. Këto shkelje, të shfaqura së bashku, shkelin parimin kushtetues të integritetit zgjedhor, i cili përcaktohet në Nenin 45 të Kushtetutës, ndikojnë drejtpërdrejt në rezultatin e votimit dhe forcojnë bazën për kërkesën e rinumërimit apo përsëritjes së votimit në këtë vendvotim specifik. Andaj, kërkoj që PZAP të aprovoj ankesën si të bazuar, të jepet urdhëri për rinumërimin e të gjitha fletëvotimeve në vendvotimin nr. 2729/03, të aplikohen masa sanksionuese, administrative ose penale, kundrejt anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit, personave të paautorizuar dhe subjekteve politike që kanë marrë pjesë në shkelje dhe që KQZ-ja të kontrollojë sërish certifikimin e rezultateve pas rinumërimit ose përsëritjes, duke u siguruar që kuota të respektohet dhe mandatet të shpërndahen në mënyrë të drejtë. Si provë i ka bashkangjitur: Kopja e certifikatës së kandidaturës, e nxjerrë nga KQZ-ja, për Zgjedhjet Lokale 2025.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 05.11.2025, ka deklaruar se lidhur me pretendimet e palës ankuese për rinumërimin e vendvotimit 2729/03, dhe pretendimet e palës për shkeljet e supozuara në këtë vendvotim, ju njoftojmë: KQZ, ju njoftoj se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 -të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, po ashtu nuk ka bashkëngjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet saj, gjithashtu pala nuk ka arrit të dëshmojë shkeljet e potencuar në ankesën e tij. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor, (duke përfshirë kamerat e sigurisë, Librat e Votimit dhe Formularët) gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë. Lidhur me pretendimet e palës ankuese për aplikimin e masave sanksionuese, administrative ose penale, kundrejt anëtarëve të KVV, dhe personave të autorizuar dhe subjekteve politike që kanë marrë pjesë në shkeljet, ju njoftojmë se KQZ, më datën 17.09.2025, ka miratuar Planin Operacional të Sigurisë, me Nr.01/2443/2025, ku përfshihen edhe institucione tjera, të cilat kanë për qëllim ofrimin e sigurisë në procesin

zgjedhor. Gjithashtu, ju njoftojmë se lidhur me rastin në fjalë, nuk është raportuar për ndonjë parregullsi në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, më datë 12.10.2025.

Lidhur me pretendimet e palës ankuese që të kontrollohet rezultatet, lidhur me kuotën gjinore dhe mandatet të shpërndahen në mënyrë të drejtë, ju njoftojmë se sipas dispozitave ligjore, përkatësisht nenit 8, paragrafit 4, në ndërlidhje me paragrafin 3, të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, përcaktohet qartazi që kuota gjinore prej 30% zbatohet brenda listave të subjekteve politike që kanë fituar mandate, me përjashtim të listave në kuadër të së cilave janë fituar dy mandate (ku ndarja bëhet në proporcion 50-50%) apo një mandat i vetëm (ku vendi i ndahet kandidatit apo kandidatës më të votuar). Të vepruarit ndryshe, sipas kërkesës së palës ankuese, do të cenonte parimin e barazisë para ligjit, në atë mënyrë që po që se kuota për institucionin në tërësi do të përmbushej vetëm nga një apo më shumë subjekte politike, të tjerat do të përjashtoheshin nga obligimi për të pasur të paktën 30% nga kandidatët e gjinisë së nën përfaqësuar që fitojnë vende në kuvendet komunale. Po ashtu, legjislacioni zgjedhor në zgjedhjet lokale nuk përcakton kuotë për kuvendin komunal si tërësi, por për listat e subjekteve, si vijon:

Në kuptim të nenit 8 paragrafi 3 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik.

"Neni 8.4 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%."

Një përcaktim i tillë është ri konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, përmes Aktgjykimit në rastet K145/20 dhe K146/20, e cila mes tjerash përcakton:

"131. Rrjedhimisht, parimet kushtetuese të barazisë gjinore dhe mos diskriminimit mbeten të një rëndësie vendimtare dhe se çështja e kuotave gjinore, për arsye historike dhe kulturore, si dhe të mënjanimin të pabarazive faktike në mes grave dhe burrave, është në pajtueshmëri me frymën e sistemit normativ kushtetues."

Në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, lidhur me formulën për ndarjen e ulëseve të Kuvendit të Komunës, si dhe numri më i vogël i kandidatëve nga gjinia e kundërt nëse numri i kandidatëve që kanë fituar mandate është dy (2) atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë një (1), pra duhet të jenë një mashkull dhe një femër. Gjithashtu, edhe tek rastet kur subjekti politik ka fituar katër (4) ulëse, atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë 2 (dy), pra duhet të jenë dy meshkuj dhe dy femra, sepse po që se do të jetë ndryshe atëherë nuk do të arrihet përfaqësimi minimal në kuotën prej 30%, i gjinisë së kundër.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e ankuesit, kandidati për asamble komunale në Komunën e Vushtrisë, nga radhët e subjektit politik LDK, Shkelzen Xhaferi, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet me prova konkrete se ka pasur parregullsi në qendrën e votimit numër 2729/03. Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se parashtruesi i ankesës nuk ka mbështetur pretendimet e tij me prova, rrjedhimisht nuk ka ofruar asnjë provë si dëshmi të qartë dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në rastin konkret, paneli, në mungesë të dëshmive nuk mund të vërtetoj se numërimi u zhvillua në mungesë të transparencës nga anëtarët e KVV, dhe personave të autorizuar që kanë marrë pjesë në këtë proces. Gjithashtu lidhur me rastin në KQZ nuk është raportuar për ndonjë parregullsi në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, më datë 12.10.2025 për rastin në fjalë.

Paneli vlerëson se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me prova konkrete, të ligjshme se ka pasur parregullsi të cilat kanë ndikuar në integritetin zgjedhor.

Po ashtu, lidhur me pretendimet me kuotën gjinore, Paneli vlerëson se janë të pa pabazuar, sepse mos respektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimum 30% të gjinisë së kundërt dhe po që se përfaqësimi është 50% nga kjo rezulton se nuk është në kundërshtim me ligjin, duke u bazuar në nenin 28 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ku përcaktohet se: *“Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëhere në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë”*.

Paneli vlerëson se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesën e paraqitur, parashtruesi ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me prova konkrete, të ligjshme se ka pasur parregullsi gjatë procesit të numërimit, andaj Paneli vlerësoj nuk është provuar me asnjë provë se ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesave në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e

Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se “*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 28 paragrafi 1, 117 paragrafi 3, dhe me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.397/2025 më datën 07.11.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.